



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË

Vorë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Vorë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 6 000 000 (gjashte milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, në pikën 2/c, neni 43, dhe pikën 4, neni 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara (3 vitet e fundit) për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të njohur me gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik të paktën për tre vitet e fundit, për të pasur siguri që operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit e vlerës së fondit limit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

b) përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikes 4/b, nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i*

kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë-Analizë për produktet e kërkuara:

- Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), S SH EN 590:2013+A1: 2017

- Benzinë pa plumb (Premium UNL 10ppm), S SH EN 228:2012+A1: 2017

lëshuar nga organi kompetent, ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar, ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi, sipas standardeve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma ”c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

Ky kriter është vendosur me qëllim konfirmimin e standarteve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim/Licencë, për tregtim me pakicë karburantesh, lëshuar nga organet kompetente.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a, VKM -se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Per përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftes, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe vkm nr. 970- datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, pasi kjo është një procedurë shumë specifike, vetëm për blerje karburanti, lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) dhe Benzine pa Plumb, e cila kërkon leje të veçantë për tregëtimin me pakicë të këtij malli.

2.3.4 Operatori duhet te ketë të ketë të paktën 1 pikë të tregëtimit të karburantit ne pronesi ose me qira , brenda territorit te Bashkisë Vorë për të cilën duhet të paraqesë :

- a. Dokumentacionin e pronësisë të stacionit të karburantit.
- b. Vertetimin teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike në fushën e tregëtimit të naftës dhe nenprodukteve te tij.
- c. Licence per stacionin e shitjes se karburanteve (per tregti me pakice).
- d. Në rast se stacioni i shpërndarjes të karburantit disponohet me qira, përvec kontratës noteriale, duhet paraqitur edhe dokumentacionit i përcaktuar në pikat a,b,c.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Argumentimi i specifikimeve teknike

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Vorë është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit. Nga ky grup janë hartuar sipas shkresave bashkëlidhur dhe është mbajtur procesverbali përkatës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Blerje gazoil 10 ppm ULSD

Gazoil 10 ppm ULSD duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 590: 2013+A1:2017 sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Blerje benzinë

Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njesia	Sasia
1.	Gazoil 10 ppm	Litër	40 616

2.	Benzine (Premium Unl 10 ppm)	Litër	4400
----	------------------------------	-------	------

Argumentim: Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzenë dhe diesel” dhe standarteve shteterore në fuqi SSH EN 590 : 2013+A1:2017, Për këtë objekt prokurimi autoriteti kontraktor ka përdorur specifikimet teknike duke ju referuar standardeve kombëtare, të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve.

Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) duhet të ketë këto karakteristika: Diezel, (Gazoil) të jetë sipas standartit EN 590 : 2013+A1:2017; Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke shërbyer për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera e fondit limit të kontratës nga grupi i punës i ngarkuar për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, është hartuar bazuar në mesataren e studimit të tregut, në mbështetj dhe zbatim të pikës 1, shkronja b) të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: *b) studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim.* Praktikë e cila është e dokumentuar me dokumentacion shkresor në dosjen e prokurimit.

NJESIA E PROKURIMIT